

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			
Nr. i prot. Br.prot./Prot.Nr.	2023/ZDP/288		
Faqe: Stranica/Pages	1	Kopje: Kopija/Copy	-
Datum/Date		22/08/2023	
Hyrës/ulazno/in	<input type="checkbox"/>		
Dalës/izlazo/out	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brendshëm/interno/internal	<input type="checkbox"/>		
Prishtinë/Priština/Pristina			

06/ZDP/VE/2023  
Datë: 22 gusht 2023

Në mbështetje të nenit 15.1 (j), nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28, dt. 4 qershor 2008), të ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 30/2022, dt. 5 shtator 2022), në përputhje me nenet 76.3 dhe 115 të Rregullores (AAC) 05/2020 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit dhe ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 10/2015 dhe shfuqizimin e Rregullores (AAC) nr. 11/2009, Rregullores (AAC) nr. 03/2009 dhe Rregullores (AAC) nr. 6/2009, Udhëzimi Administrativ (AAC) nr. 02/2021 për zbatimin e specifikimeve të certifikimit, mjeteve të pranueshme të pajtueshmërisë dhe materialeve udhëzuese të AESA,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr:

### VENDIM

1. Për zbatim në rendin juridik të Republikës së Kosovës të specifikimeve të certifikimit, mjeteve të pranueshme të pajtueshmërisë dhe materialeve udhëzuese bazuar në vendimet e lëshuara nga AESA, në fushën e aerodromeve, si në vijim:
  - a. Mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë/materialet udhëzuese (AMC/GM) :
    - i. Vendimi Ekzekutiv nr. 2022/013/R, i datës 06 korrik 2022, “Operimet në çfarëdo kushte të motit– AMC/GM për rregullat e Aerodromeve” - botimi fillestar, Amandamenti 6;
    - ii. Vendimi Ekzekutiv nr. 2022/016/R, i datës 23 gusht 2022, “Publikimin e Informatave Aeronautike (AIP) – AMC/GM për rregullat e Aerodromeve”- botimi fillestar, Amandamenti 7” ;
    - iii. Vendimi Ekzekutiv nr. 2023/003/R, i datës 24 mars 2023, “Shërbimet e shpëtimit dhe zjarrfikjes për fluturimet e Aviacionit të Përgjithshëm- AMC/GM për rregullat e Aerodromeve”– botimi fillestar, Amandamenti 8”.
2. Pika i) e këtij Vendimi fillon të zbatohet nga data 30.09.2023, ndërsa pikat ii) dhe iii) me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Iu dërgohet:

- Departamentit të Aerodromeve;
- Operatorit të ANP “Adem Jashari”;
- Arkivit të AAC-së.